

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime te tjera

Nr	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
23	Rregullat e Kodit Zgjedhor për ndarjen e kohës së transmetimit për garuesit zgjedhorë duhet të ndryshohen për të reduktuar avantazhin e partive kryesore parlamentare në programet editoriale dhe për të garantuar një ndarje më të drejtë të kohës për të gjitha partitë garuese.	Progres i Munguar	Zgjidhja në Kodin Zgjedhor e problemit që adreson ky rekomandim është rezultat i përvojave të mëparshme legjislative, të hartuara në përputhje me parimin e proporcionalitet. Ndryshimet dhe zhvillimet intensive në median audiovizive, në veçanti median private dhe median sociale duhet të reflektohen në zgjidhjet që duhet të përfshihen në legjislacionin e ndryshuar i cili do të bëjë të mundur një ndarje më të drejtë të kohës në media të partive politike garuese në procesin zgjedhor.